

Maj 2023

Raport nga  
Grupi për Studime  
Juridike dhe Politike

# Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë

**ROLPIK**

rolpik.org

**DREJTËSIA SOT**

rolpik.org/justicetoday

**BOTIMI I TETË**





## **Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë Botimi i Tetë**

Maj 2023

©Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë, Maj, 2023

Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, stafit, bashkëpunëtorëve ose përfaqësuesve të tyre. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme apo nga çfarëdo mjete pa leje. Kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike për kërkesat e tilla.

### **Grupi për Studime Juridike dhe Politike**

Rr. "Rexhep Luci" 16/1

Prishtinë 10 000, Kosovë

[www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)

office@legalpoliticalstudies.org

+381 38 234 456

## HYRJE

Perceptimi qytetarë paraqet përshtypjen e qytetarëve të një vendi për institucione të cilat janë ndërtuar dhe që kanë për obligim zbatimin e normave ligjore, prandaj ky indikator vlerësohet si shumë i rëndësishëm në vlerësimin e punës së autoriteteve shtetërore.

Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë (RoLPIK) është mekanizëm monitorimi, i hartuar për të vlerësuar punën e institucioneve më fokus të veçantë në sistemin e drejtësisë në Kosovë. RoLPIK tashmë shërben si platformë me të dhëna të hapura, të qasshme për publikun e gjerë, ku nga viti 2013 e deri në vitin 2022, analizohet e pasqyrohet puna e institucioneve të sistemit të drejtësisë në Kosovë si dhe ku ofrohen të dhëna mbi perceptimet dhe eksperiencat e qytetarëve të Kosovës në veprimtaritë e këtyre institucioneve përgjatë viteve.

RoLPIK – Botimi i Tetë përmban të dhëna lidhur me perceptimin qytetarë ndaj institucioneve ligjzbatuese, raportet e punës së gjykatave dhe prokurorive dhe buxhetin e ndarë për sistemin gjyqësor dhe prokurorial gjatë vitit 2022. Këto të dhëna janë bazuar në tri komponentë, a) matjen e perceptimit qytetarë në raport me institucionet ligjzbatuese përmes anketës së realizuar me 1065 respondentë<sup>1</sup>; b) efikasiteti i gjyqësorit bazuar në raportet zyrtare të punës së gjykatave dhe prokurorive në nivel vendi; dhe c) ndarjen buxhetore për sistemin gjyqësor dhe prokurorial në raport me buxhetin e tërësishëm të Republikës së Kosovës.

Në shtatë botimet paraprake të RoLPIK-ut u analizuan këto të dhëna për periudhën 2013 deri në 2021<sup>2</sup>, ndërsa botimi i tetë përveç indikatorëve nga botimet paraprake,

trajton edhe perceptimin qytetarë karshi disa dukurive dhe iniciativave legislative që kanë karakterizuar shoqërinë kosovare gjatë vitit 2022. Kësisoj, në këtë edicion janë analizuar edhe të dhënat lidhur me perceptimin e qytetarëve për iniciativën e Qeverisë së Kosovës për reformimin e sistemit të drejtësisë, përfshirë vettingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve<sup>3</sup>, si dhe nismën ligjore për konfiskimin civil të pasurisë së pajustificueshme<sup>4</sup>. Risi e këtij edicioni është edhe indikator i që përmban perceptimin qytetarë lidhur me atë se si e vlerësojnë të anketuarit nivelin e sigurisë në vend pas fillimit të luftës në Ukrainë<sup>5</sup> dhe përsëritjen e shpeshtë të incidenteve në katër komunat veriore të Kosovës të banuara kryesisht me qytetarë të komunitetit serb (Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq e Zveçan)<sup>6</sup>. Po ashtu, nga anketa e realizuar në shtator të vitit 2022, ky edicion trajton edhe përshtypjet e të anketuarve se sa meritore (parandaluese) i konsiderojnë dënimet për rastet e dhunës në familje apo mbi baza gjinore.

Lidhur me reformat në sistemin gjyqësor, duhet përmendur faktin që sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdimisht është karakterizuar me nisma të ndryshme të cilat kryesisht kanë rezultuar me ndryshime legislative, me krijimin e mekanizmave të rinj ose shuarjen e tyre si dhe ri-aranzhim kompetencash brenda institucioneve të ndryshme. Të njëjtat janë cilësuar të jenë

1 Anketa e realizuar nga kompania UBO Consulting gjatë muajit shtator 2022, ku në nivel vendi u intervistuan 1065 anketues, të gjithë mbi moshën 18 vjeçare.

2 Shtatë botimet paraprake të RoLPIK janë të qasshme në linku <https://www.rolpik.org/justicetoday/>

3 Radio Evropa e Lirë, "Kurti dhe Haxhiu ia dorëzojnë Konjufcës dosjen për vettingun në drejtësi", shtator 2022, e qasshme në linkun: <https://www.evropaelire.org/a/vettingu-kurti-haxhiu-konjufca-/32017790.html>

4 Bota Sot, "Qeveria miraton Projektligjin për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme", dhjetor 2021, e qasshme në linkun: <https://www.botasot.info/aktuale-lajme/1733468/qeveria-miraton-projektligjin-per-verifikimin-dhe-konfiskimin-e-pasurise-se-pajustificueshme/>

5 ABC News, "Plas lufta! Rusia nis pushtimin e Ukrainës", shkurt 2022, e qasshme në linkun: <https://abcnews.al/plas-lufta-rusia-nis-pushtimin-e-ukraines/>

6 Nacionale, "Gjashtë sulmet ndaj Policisë në veri – ende asnjë i dyshuar, hetimet mbesin sekret", prill 2022, e qasshme në linkun: <https://nacionale.com/drejt%20%20ABsi/gjashte-sulmet-ndaj-policise-ne-veri-ende-asnje-i-dyshuar-hetimet-mbesin-sekret-7664>



kryesisht ndryshime sipërfaqësore të cilat nuk kanë arritur të trajtojnë problemet në thelbin e tyre, sikurse mangësinë serioze që sistemi i drejtësisë ka në sigurimin e drejtësisë, pavarësisë dhe paanshmërisë nga akterët politikë, mungesën e rezultateve konkrete në luftën kundër dukurive negative, me theks të veçantë në veprat penale të korrupsionit e krimit të organizuar.

Trajtimi adekuat i këtyre sfidave të gjyqësorit nuk u arrit as me reformën në drejtësi të janarit të vitit 2013, ku u formua sistem i ri të gjykatave dhe prokurorive në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, vlen të përmenden edhe dy nismat paralele të Ministrisë së Drejtësisë, të cilat u zhvilluan përgjatë viteve 2018 – 2019, me qëllim kryesor të rikthimit të besimit të qytetarëve në drejtësi. Bëhet fjalë për agjendën “Drejtësia 2020”<sup>7</sup> dhe “Rishikimin Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit (RFSSL)”<sup>8</sup> por, për shkak të rënies së Qeverisë, të njëjtat nuk arritën të përfundojnë brenda periudhës së planifikuar kohore.

Kurse, gjatë vitit 2021, Qeveria e Kosovës miratoi Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021-2026<sup>9</sup>, me të cilën synohet fuqizimi i gjyqësorit dhe i prokurorisë, i drejtësisë penale, qasjes në drejtësi dhe luftës kundër korrupsionit. Kjo strategji është produkt i procesit të RFSSL-së, që ishte dizajnuar në atë mënyrë që të ofrojë analizë të thuktë dhe të detajuar të problemeve në fushën e sundimit të ligjit. Si rezultat i kësaj strategjie dhe planit të veprimit të saj, gjatë vitit 2022, u draftuan një numër i konsiderueshëm i plotësimit/ndryshimeve të ligjeve, me theks të veçantë ai për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK),

Prokurorin e Shtetit, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, Kodi Civil etj.<sup>10</sup> Po ashtu, gjatë vitit të kaluar, Komisioni i Venecias, edhe pse me disa vërejtje, e vlerësoi pozitive nismën për Vettingun në drejtësi që përfshin gjyqtarët dhe prokurorët që mbajnë pozita udhëheqëse në kuadër të sistemit gjyqësor dhe prokurorial<sup>11</sup>, e po ashtu edhe atë për krijimin e Byrosë shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme<sup>12</sup>. Risi tjetër në sistemin gjyqësor ishte edhe krijimi dhe funksionalizimi i Gjykatës Komerciale, e cila do të veprojë si shkallë e parë dhe e dytë në zgjidhjen e kontesteve biznesore.<sup>13</sup>

Pavarësisht numrit të lartë të reformave të iniciuara e të zhvilluara në sektorin e drejtësisë, Botimi i tetë i RoLPIK-ut vë në pah se edhe në vitin 2022 vazhdon trendi i ultë i vlerësimit qytetarë për funksionimin e sistemit të drejtësisë në vendin tonë.

7 Ministri Tahiri: “Drejtësia 2020” do t’i jap fund tranzicionit në sistemin e drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, shtator 2018, e qasshme në linkun: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,1891>

8 Rishikimi Funkcional në Sektorin e Sundimit të Ligjit (RFSSL), Ministria e Drejtësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, e qasshme në linkun: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,144>

9 Strategjia e Sundimit të Ligjit 2021-2026, Ministria e Drejtësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, Gusht 2021, e qasshme në linkun: <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-ODF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>

10 Raporti gjashtëmujor për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë për sundimin e ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës, korrik 2022, e qasshme në linkun: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/08/Raporti-6-mujor-per-zbatimin-e-PV-te-Strategjise.pdf>

11 Opinioni i Komisionit të Venecias, qershor 2022, i qasshëm në linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2022\)011-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2022)011-e)

12 Opinioni i Komisionit të Venecias, dhjetor 2022, i qasshëm në linkun: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2022\)052-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2022)052-e)

13 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, “Gjykata Komerciale pranon shkresat e para”, gusht 2022, link: <https://www.gjyqesori-rks.org/2022/08/01/gjykata-komerciale-pranon-shkresat-e-para/>

Gjetjet kryesore në kuadër të Indeksit të Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë (RoLPIK) – Botimi i tetë, janë këto:

- 62.5% e të anketuarve konsiderojnë se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji;
- Të pyetur se cilat nga institucionet influencohen më shumë nga ndikimi politik, 36.7% e të anketuarve në vend të parë i vendosin Gjykatat, 33.4% e tyre e shohin këtë ndikim në Prokurorinë e Shtetit ndërsa 17.4% tjerë vlerësojnë se Policia e Kosovës influencohet me shumë nga politika;
- 46.5% e të anketuarve besojnë se zyrtarët/punëtorët e institucioneve të drejtësisë kërkojnë/pranojnë ryshfet. Të pyetur se cilat institucione janë më të prirur për këtë fenomen, të anketuarit konsiderojnë se në vendin e parë janë Gjykatat me 36.9%, më pas Prokuroria me 31.3% dhe Policia me 21.1%;
- 53.2% e të anketuarve vlerësojnë se Policia e Kosovës është institucioni më efektiv në luftën kundër korrupsionit. Lidhur me këtë çështje, Prokuroria me 6.3% dhe Gjykatat me 4.7% vlerësohen si institucionet më pak efektive në luftën kundër veprave penale të korrupsionit;
- Pavarësisht mungesës së besimit në institucionet e drejtësisë, 74.7% e të anketuarve kanë theksuar se janë të gatshëm të raportojnë rastet e korrupsionit dhe veprat penale. Ndërsa të pyetur se në cilin institucion do të raportonin korrupsionin apo veprat tjera penale, rreth 91% e të anketuarve kanë zgjedhur Policinë e Kosovës, 1.6% Gjykatën dhe 0.4% Prokurorinë;
- Ndërmjet vlerës 1="Aspak i kënaqur" dhe vlerës 5="Plotësisht i kënaqur", të anketuarit kanë theksuar se më të kënaqur janë me punën/performancën e Policisë së Kosovës (3.85), pastaj me Gjykatat (2.76) dhe Prokurorinë (2.72);
- Vetëm 7.2% e të anketuarve pajtohen plotësisht që institucionet e drejtësisë i trajtojnë njësoj personat/grupet e marginalizuara si: gratë, minoritetet, personat me aftësi të kufizuara, personat me të ardhura minimale;
- Të pyetur se cilat nga institucionet e Kosovës janë në gjendje të kryejnë detyrat/përgjegjësitë e tyre në mënyrë të pavarur, të anketuarit në vend të parë e vendosin Policinë e Kosovës (46.5%), më pas Gjykatat (15.1%) dhe Prokurorinë (14.3%);
- Sa i përket vendimmarrjes së gjykatave, 45% e të anketuarve mendojnë se shumica e gjyqtarëve vendimet i marrin nën ndikimin e presionit të ushtruar nga interesat private/korrupsionit ndërsa 26.8% e tyre vlerësojnë se këto vendime merren nën ndikimin e presionit të ushtruar nga zyrtarët e lartë/personat me influencë politike. Kurse, vetëm 26.9% e të anketuarve kanë vlerësuar që vendimet gjyqësore merren në faktet e disponueshme dhe në kornizën ligjore të vendit.
- 54.1% e 1065 të anketuarve vlerësojnë se nuk ka pasur përmirësim në sistemin e drejtësisë gjatë viteve të fundit ndërsa 31% e tyre janë përgjigjur se kanë parë përmirësim në sistemin e drejtësisë. Këta të fundit kanë theksuar se gjyqësori më së shumti është përmirësuar në llogaridhënie dhe transparencë;
- Vetëm 6.5% e të anketuarve pajtohen plotësisht se Gjykatat dhe Prokuroritë kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët prokurorët nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet, apo frikësimet;
- Nga të dhënat e anketës rezultojnë se vetëm 31.9% e personave që janë intervistuar kanë marrë/pranuar shërbime gjatë 5 viteve të fundit nga institucionet e drejtësisë (Policia, Prokuroria, Gjykata);

- Ndërmjet vlerës 1="Aspak të mira" dhe vlerës 5="Plotësisht të mira", nga mesatarja e përgjigjeve të të anketuarve rezultoi se me 3.6 janë vlerësuar iniciativat e ndërmarrja nga Qeveria e Kosovës (Ministria e Drejtësisë) për të reformuar sistemin e drejtësisë, përfshirë vettingun dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme.
- Të anketuarit nuk e vlerësojnë plotësisht të sigurtë gjendjen e sigurisë në vend pas fillimit të luftës në Ukrainë dhe tendencave për destabilizimin e situatës në Veri të Kosovës. Kësisoj, ndërmjet vlerës 1="Aspak të sigurtë" dhe vlerës 5="Plotësisht të sigurt", nga mesatarja e përgjigjeve të të anketuarve rezultoi se nivelin e sigurisë në vend e vlerësojnë me vlerën 3.42;
- Të pyetur se nga 1="Aspak meritore" deri në 5="Plotësisht meritore", sa konsideroni që janë të drejta dhe parandaluese dënimet për rastet e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, nga mesatarja e përgjigjeve të të anketuarve rezultati është 2.97.
- Gjatë vitit 2022, buxheti i ndarë për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) ishte 32 milion e 200 mijë euro, apo rreth 1.2% e buxhetit total të Republikës së Kosovës, kurse për Këshillin Prokurorial të Kosovës ishte ndarë buxhet rreth 17 milion e 145 mijë euro, apo 0.6% e total buxhetit të vendit tonë për vitin 2022.
- Gjykata Komerciale nga muaji gusht deri në dhjetor 2022, ka pasur në punë 10 mijë e 45 lëndë ndërsa ka zgjidhur vetëm 1 mijë e 39 prej tyre;
- Gjatë kësaj periudhe raportuese gjykatat (Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme, Gjykata e Apelit, shtatë Gjykatat Themelore dhe Gjykata Komerciale) kishin në punë 381 mijë e 786 lëndë ndërsa kanë zgjidhur 119 mijë e 370 lëndë, apo 31.2%. Nëse marrim raportin mes lëndëve të reja dhe atyre të zgjidhura gjatë vitit 2022 rezultoi se të gjitha gjykatat së bashku treguan efikasitet prej 78.3%, pra nuk është arritur të zgjidhen lëndë as sa numri i atyre të pranuar gjatë një viti kalendarik;
- Sa i përket ngarkesës me lëndë të gjyqtarëve, nga numri total i lëndëve që ishin në punë gjatë vitit 2022, në raport me numrin e gjyqtarëve që shërbejnë në gjykatat përkatëse, rezultoi se një gjyqtar i Dhomës së Posaçme ishte i ngarkuar me 1246 lëndë, ai i themelores me 1091 lëndë, pastaj gjyqtari në Gjykatën Komerciale me 1005 lëndë, ai i Apelit me 642 lëndë dhe gjyqtari i Supremes me 114 lëndë;
- Gjatë vitit 2022, Prokurori i Shtetit (Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës dhe shtatë Prokuroritë Themelore) kishte në punë 132 mijë e 950 lëndë ndërsa ka zgjidhur vetëm 33.2% të tyre apo 44 mijë e 247 lëndë. Nëse marrim raportin mes lëndëve të reja dhe atyre të zgjidhura gjatë vitit 2022 rezultoi se Prokurori i Shtetit ka treguar efikasitet prej 86.8%, pra as ky institucion nuk ka arritur të zgjidh lëndë as sa numri i atyre të pranuar gjatë një viti kalendarik;
- Sa i përket ngarkesës me lëndë të prokurorëve, nga numri total i lëndëve që ishin në punë gjatë vitit 2022 në raport me numrin e prokurorëve që shërbejnë në sistemin prokurorial rezultoi se një prokuror në Prokurorinë e Apelit ishte i ngarkuar me 1115 lëndë, ai i themelores me 821 lëndë, pastaj prokurori në ZKPSH me 160 lëndë dhe prokurori i PSRK-së me 128 raste;
- Nëse marrim për bazë efikasitetin e treguar nga Prokurori i Shtetit dhe Gjykatat gjatë vitit 2022, këtyre institucioneve do t'iu duhen së paku tre vite për t'i zgjidhur të gjitha rastet që i kanë në punë, me kusht që nuk pranojnë lëndë të reja gjatë kësaj periudhe kohore.

## METODOLOGJIA

Ky raport është bazuar në të dhënat parësore si perceptimi qytetar dhe ato dytësore si raportet zyrtare nga organet përgjegjëse dhe menaxhuese të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Të dhënat parësore përfshijnë anketimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës gjatë muajit shtator 2022, të realizuara në bashkëpunim me UBO Consulting.

Anketa është reprezentative për vendin dhe në të kanë marrë pjesë qytetarë të gjinive, grupmoshave, nivelit të shkollimit, punësimit dhe të ardhurave ekonomike të ndryshme. Kësisoj, vlen të theksohet se në 19 pyetje me opsione të përgjigjeve të shumëfishta dhe rotative, janë anketuar 1065 qytetarë, ku 49.7% e të anketuarve janë burra ndërsa 50.3% janë gra, të gjithë të moshës madhore mbi 18 vjeç. Sa i përket komponentës së vendbanimit të 1065 të anketuarve, 42.6% e tyre janë qytetarë që jetojnë në vendbanime urbane ndërsa 57.4% që jetojnë në vendbanime rurale. Në bazë të të dhënave parësore të nxjerra nga anketimi janë hartuar indikatorët e perceptimit të cilët vlerësojnë perceptimin e qytetarëve të Kosovës mbi punën e institucioneve të sundimit të ligjit: gjykatave, prokurorisë dhe policisë.

Të dhënat dytësore për të vlerësuar efikasitetin e punës në gjykata dhe prokurori janë mbledhur dhe analizuar nga raportet zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovë (KGJK)<sup>14</sup>, Prokurorit të Shtetit<sup>15</sup> dhe Ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022<sup>16</sup>.

Më konkretisht, janë analizuar të dhënat për numrin e lëndëve të pranuara, lëndëve të trashëguara dhe atyre të zgjidhura brenda një viti në secilën gjykatë dhe prokurori me numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe buxhetin e ndarë për sistemin gjyqësor dhe prokurorial gjatë viteve 2013-2022. Indikatorët strukturorë pasqyrojnë kapacitetet dhe resurset e prokurorive dhe gjykatave për të realizuar detyrat e tyre, duke mundësuar në këtë mënyrë vlerësimin e efikasitetit të punës së tyre. Meqë nga janari i vitit 2013 ka hyrë në fuqi struktura e re e gjyqësorit, indikatorët bazohen në të dhënat e viteve 2013-2022. Duhet theksuar se vlerësimi dhe analizimi i numrit të lëndëve të zgjidhura apo të trashëguara brenda një viti në secilën gjykatë dhe prokurori, është bërë pa vlerësuar vështirësinë e zgjidhjes së tyre, apo ndarjen në departamente të ndryshme të gjykatave dhe prokurorive. Kjo pasi qëllimi kryesor në ndërtimin e indikatorëve strukturorë është që të vlerësojë efikasitetin total të punës së gjykatave dhe prokurorive si dhe të vlerësojë performancën individuale sasiore të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

14 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti statistikor i gjykatave vjetor 2022, i qasshëm në linkun: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114\\_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf)

15 Këshilli Prokurorial i Kosovës, Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2022, i qasshëm në linkun: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/RAPORTI%20VJETOR%20I%20PROKURORIT%20TE%20SHTETIT%202022.pdf>

16 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, link: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F77FA35-E121-43D3-9683-791BOADE3337.pdf>





**PERCEPTIMI  
QYTETAR MBI  
INSTITUCIONET  
E SISTEMIT TË  
DREJTËSISË**

## NDIKIMI POLITIK NË SISTEMIN E DREJTËSISË


Edhe gjatë vitit 2022, në Kosovë mbetet shqetësues fakti se shumica e të anketuarve konsiderojnë se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji. Të dhënat tregojnë se 62.5% e qytetarëve janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen “A mendoni se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji?”. Ndërsa, vetëm 22.7% e tyre mendojnë se pavarësisht që personat mund të kenë ndikim politik, të njëjtit kanë gjasa të ndëshkohen në bazë të dispozitave ligjore. Nëse krahasojmë të dhënat me vitin e kaluar, trendi i qytetarëve që besojnë se sistemi i drejtësisë ndikohet nga figurat politike është rritur për 2.5 pikë përqindje.

A mendoni se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji?




Nga të anketuarit të cilët besojnë se personat me ndikim politik kanë më pak gjasë të ndëshkohen nga ligji, 36.7% e tyre mendojnë se gjykatat janë institucionet që influencohen më së shumti nga ndikimi politik. Lidhur me këtë dukuri, qytetarët në vendin e dytë e vendosin Prokurorinë me 33.4% dhe Policinë e Kosovës me 17.4%. Në bazë të këtyre të dhënave rezultoi se në vitin 2022, është rritur përqindja e qytetarëve që mendojnë se gjykatat dhe prokuroritë ndikohen më së shumti nga politika, me 3.8 pikë përqindje përkatësisht 2.1 pikë përqindje, ndërsa është ulur për 2.3 pikë përqindje perceptimi i qytetarëve që mendojnë se Policia influencohet nga politika.

Cilat nga institucione në vazhdim influencohen më shumë nga ndikimi politik?




## MITMARRJA

Qytetarët e anketuar konsiderojnë që institucionet e drejtësisë vazhdojnë të jenë të prekura nga dukuria e mitmarrjes. Më konkretisht, të dhënat tregojnë se 46.8% e të anketuarve mendojnë se punëtorët dhe zyrtarët e institucioneve të drejtësisë pranojnë ose kërkojnë ryshfet. Krahasuar me vitin paraprak, këto të dhëna tregojnë se këtë vit kemi rritje prej 7 pikë përqindje të të anketuarve që mendojnë se ryshfeti është prezent në institucionet e drejtësisë, përkatësisht se zyrtarët e këtyre institucioneve kërkojnë ose pranojnë mito.




### Zyrtarët/punëtorët e cilit institucion në vazhdim kërkojnë/pranojnë mito?

I anketuari mund të përgjigjet në më shumë se një përgjigje



Edhe në këtë vit, sikurse në atë paraprak, shumica e të anketuarve besojnë se institucionet më të prekura nga kjo dukuri janë gjykatat me 36.9% dhe prokuroria me 31.3%. Kurse, praktika e kërkimit apo pranimit të ryshfetit sipas të anketuarve është më pak prezentë tek Policia e Kosovës (21.1%), edhe pse në krahasim me vitin 2021, ky perceptim është rritur për 0.4 pikë përqindje. Lidhur me këtë çështje, vetëm 9.3% të të anketuarve kanë shprehur mendimin e tyre se zyrtarët e EULEX-it kërkojnë apo pranojnë mito. Përqindja kaq e lartë e perceptimit qytetarë për prezencën e mitos në institucionet kyçe të cilat do të duhej të implementonin dhe të zbatonin ligjin, me theks të veçantë në gjykata e prokurori, është sinjal tejet negativ dhe pengesë serioze në përmirësimin e imazhit dhe rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë.



### Sipas mendimit tuaj, zyrtarët/punëtorët e institucioneve të drejtësisë (Policisë, Gjykatave, Prokurorisë, Eulex-it etj) a kërkojnë/pranojnë mito?



## EFEKTIVITETI NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

Edhe këtë vit, qytetarët e vendosin Policinë e Kosovës si institucionin më efektiv në luftimin e korrupsionit. Për dallim nga viti i kaluar ku kjo përqindje ishte 38.2%, në këtë vit rreth 53.2% e të anketuarve besojnë se ky institucion ka shënuar sukses dhe efektivitet në luftimin e dukurisë së korrupsionit. Kurse, sinjal negativ është se gjykatat (4.7%) dhe prokuroria (6.3%) këtë vit kanë shënuar ulje të përqindjes së atyre që mendojnë se të njëjtat janë efektive sa i përket luftës kundër korrupsionit. Megjithatë, këtë vit, vërejmë rritje të vlerësimit pozitiv të të anketuarve edhe karshi rolit të mediave sa i përket efikasitetit në luftimin e kësaj dukurie negative.


Sipas mendimit tuaj, cili nga institucionet në vazhdim është më efektiv në luftën kundër korrupsionit?



## GATISHMËRIA PËR TË RAPORTUAR KORRUPSIONIN DHE VEPRAT TJERA PENALE



Gatishmëria e qytetarëve të Kosovës për të raportuar korrupsionin dhe veprat penale ekziston në masë të madhe përkundër faktit që ata janë të pakënaqur me punën e institucioneve në luftimin e këtyre dukurive në shoqëri. Të pyetur nëse do të ishin të gatshëm të raportonin një rast korrupsioni apo krimi, 74.7% kanë deklaruar se janë të gatshëm ta raportojnë, ndërsa 18.3% kanë deklaruar të kundërtën. Krahasuar me vitin e kaluar, trendi i gatishmërisë për raportimin e korrupsionit tek institucionet relevante është në rritje, më konkretisht vërejmë rritje me 5 pikë përqindje (nga 23.3 në vitin e kaluar në 28.3%). Rritja e përqindjes së qytetarëve për të ndihmuar institucionet në luftimin e krimit dhe korrupsionit paraqet një tendencë të aktivizimit qytetar për të kontribuar në adresimin dhe luftimin e dukurive negative, por ajo që mbetet shqetësuese është niveli i pakënaqësisë së qytetarëve me shkallën e efikasitetit të këtyre institucioneve trajtimin e rasteve të tilla.

Të pyetur se në cilin institucion do të raportonin korrupsionin, 90.9% e të të anketuar janë përgjigjur se do të raportonin në Polici. Nëse bëjmë krahasim me vitin e kaluar, rezulton se kemi rritje prej 12.3 pikë përqindje të qytetarëve të cilët do të raportonin një rast të krimit ose korrupsionit në Policinë e Kosovës. Kurse, nga të dhënat e anketës rezulton se këtë vit kemi ulje të përqindjes së qytetarëve që do të ishin të gatshëm të raportonin veprat penale në gjykata, prokurori, EULEX, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK) dhe në media. Ky rezultat i anketave tregon se Policia vazhdon të jetë adresa më e besueshme e qytetarëve për të raportuar veprat penale, por mbetet shqetësuese ulja e përqindjes së qytetarëve për raportim të këtyre dukurive në gjykata e prokurori.



Në cilin institucion do ta raportonit?

Në qoftë se do të vërenit ndonjë rast të korrupsionit apo krimit (vjedhje, dhune, etj), a do të ishit të gatshëm ta raportonit?






## KËNAQSHMËRIA E QYTETARËVE ME PERFORMANCËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Indikatori i kënaqshmërisë tregon sesa institucionet e drejtësisë veprojnë në përputhje me pritshmërinë e qytetarëve dhe përgjegjësitë e tyre. Më saktësisht, të anketuarit janë pyetur: “Sa jeni të kënaqur me punën apo performancën e këtyre institucioneve” me mundësi të përgjigjes nga vlera 1 që korrespondon me aspak të kënaqur deri në vlerën 5 plotësisht të kënaqur. Të dhënat, për vitin 2022, ngjashëm si në vitet e kaluara tregojnë se qytetarët janë më të kënaqur me Policinë e Kosovës, ndërsa shumë pak të kënaqur me EULEX-in.



Sa jeni të kënaqur me punën/performancën e këtyre institucioneve?


1=Aspak i kënaqur dhe  
5=Plotësisht i kënaqur



Sa i përket perceptimit të të anketuarve lidhur me trajtimin e barabartë nga institucionet e drejtësisë karshi personave/grupeve të marginalizuara gjejmë se vetëm 28.3% dhe 7.2% nga totali i të intervistuarve pajtohen ose pajtohen plotësisht që institucionet i trajtojnë njësoj të gjithë personat/grupet e cekura me lartë. Ndërsa, siç shihet edhe nga vlerat e dhëna në tabelë, 42.6% e të anketuarve pajtohen deri diku (vlera 3) se institucionet e drejtësisë i trajtojnë barabartë personat/grupet e marginalizuara, ndërsa të anketuarit e tjerë vlerësojnë se këto institucione nuk i trajtojnë në mënyrë të barabartë gratë, minoritetet, personat me aftësi të kufizuara, personat me të ardhura minimale.

Ju lutem na tregoni se sa pajtoheni me deklaratën në vazhdim:

“Institucionet e drejtësisë i trajtojnë njësoj personat/grupet e marginalizuara si: gratë, minoritetet, personat me aftësi të kufizuara, personat me të ardhura minimale”




## PAVARËSIA NË VENDIMARRJE

Që një shtet të ketë sistem funksional të së drejtës ai duhet të karakterizohet dhe të promovojë parimet e rëndësishme si pavarësia dhe paanshmëria. Sa i përket pavarësisë së institucioneve të cilat mbrojnë ligjshmërinë, 46.5% e qytetarëve edhe këtë vit e radhisin policinë si institucion që mund të kryej detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë të pavarur. Ndërsa, vetëm 15.1% respektivisht 14.3% e të anketuarve mendojnë se Gjykatat dhe Prokuroria mund të jenë të pavarura në ushtrimin e detyrës së tyre. Këtë vit, përqindja e qytetarëve që besojnë se policia mund të kryej punë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme është rritur për 5.3 pikë përqindje, kurse mbetet shqetësues fakti i uljes së pikë përqindjes tek gjykatat me 3.6, Prokuroria me 1.6 dhe EULEX-i me 2.9 pikë përqindje.


Perceptimi i qytetarëve për vitin 2022 tregon se gjyqtarët janë më pak të pavarur dhe të paanshëm në rastet e vendimmarrjes gjë e cila reflekton edhe në besimin e ultë të qytetarëve karshi sistemit të drejtësisë në vend. Kësisoj, 71.7% e të anketuarve vlerësojnë se gjyqtarët i marrin vendimet e tyre nga ndikimi i presionit të ushtruar nga interesat privat/korrupsionit (45%) dhe nga ndikimi i presionit të ushtruar nga zyrtarët e lartë/personat me influencë politike (26.8%). Ndërsa, vetëm 26.9% e të anketuarve mendojnë se vendimet e gjyqtarëve merren në bazë të fakteve të disponueshme dhe sipas kornizën ligjore aktuale.

Sipas mendimit tuaj, në praktikë, cilat nga **institucionet** e Kosovës në vazhdim janë në gjendje të kryejnë detyrat/përgjegjësitë e tyre në mënyrë të **pavarur**?



Sipas mendimit tuaj, gjatë marrjes së vendimit shumica e **gjyqtarëve** në Kosovë bazohen:


Në faktet e disponueshme dhe në kornizën ligjore të vendit  
**26.9%**




Në ndikimin e presionit të ushtruar nga interesat privat/korrupsionit  
**45%**



Në ndikimin e presionit të ushtruar nga zyrtarët e lartë/ personat me influencë politike  
**26.8%**



Tjetër  
**1.4%**



## PËRMIRËSIMI I GJYQËSORIT

Përkundër agjendës “Drejtësia 2020”, Procesit të Rishikimit Funkcional, Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe nismave tjera ligjore nga Ministria e Drejtësisë gjatë vitit 2022, me qëllim kryesor sigurimin e mbarëvajtjes dhe rikthimin e besimit të qytetarëve në drejtësi, ende më shumë se gjysma e qytetarëve mendojnë të kenë vërejtur përmirësim në sistemin e drejtësisë. Kështu, nëse e krahasojmë përqindjen e këtij viti me atë të kaluarin të qytetarëve që e ndajnë këtë mendim rezulton se kemi rritje prej 2.6 pikë përqindje. Ndërsa, për 5.8 pikë përqindje është ulur numri i qytetarëve që mendojnë se ka pasur përmirësim të sistemit të drejtësisë gjatë viteve të fundit. Kështu, kjo përqindje në vitin 2021 ishte 37.3% ndërsa në vitin 2022 është vetëm 31.5%. Ndërsa, 14.4% të të anketuarve kanë zgjedhur të mos përgjigjen apo kanë vlerësuar se nuk e din nëse ka pasur përmirësime në sistemin e drejtësisë apo jo.

Sipas mendimit tuaj, a është përmirësuar sistemi i drejtësisë gjatë viteve të fundit?




Po	Jo	Nuk e di/ Pa përgjigje
<b>31.5%</b>	<b>54.1%</b>	<b>14.4%</b>



Kurse nga përqindja e të anketuarve që kanë pohuar se sistemi gjyqësor është përmirësuar, pjesa më e madhe e tyre (34.1%) mendojnë që sistemi i drejtësisë tashmë është më transparent dhe llogaridhënës. Ky perceptim qytetarë mund të lidhet me vendimet e KGJK-së për hapjen e gjyqësorit në raport me publikun, transmetimin online të mbledhjeve të Këshillit, Asamblesë së Kryetarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës të gjykatave, publikimin e vendimeve të kryetarëve të gjykatave mbi ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve, konferencat më të shpeshta për media si nga sistemi prokurorial dhe ai gjyqësor për të dhënë sqarime e informata publikut të gjerë për çështje me interes të gjerë, etj.

Cili nga këto dimensionet e sistemit të drejtësisë është përmirësuar më së shumti?



**34.1%**

Llogaridhënia dhe transparenca

**23%**

Mbyllja/zgjidhja më e shpejtë e rasteve

**20.4%**

Ndikim më i vogël i politikanëve mbi gjyqtarët

**21.8%**

Hetimi i rasteve të korrupsionit

**0.7%**

Tjetër


## KUSHTET E PUNËS

Sa i përket çështjes se a merren masa disiplinore deri në largim nga puna ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve për shkelje të rregullave apo procedurave, këtë vit është rritur përqindja e të anketuarve që besojnë se kjo ndodh shpesh ose gjithmonë (6.4% në vitin 2022 ndërsa 5.9% në vitin 2021). Në rritjen e kësaj përqindje mund të kenë ndikuar vendimet e KPK-së dhe KGJK-së gjatë vitit 2022 për degradimin në detyrë të gjyqtarëve Driton Muharremi, Naime Krasniqi-Jashanica dhe Florije Zatriqi, prokurores Shemsie Asllani e Kryeprokurorit të Gjakovës, Ramiz Buzhala. Pavarësisht kësaj, edhe gjatë vitit 2022, rezulton se shumica e të anketuarve ndajnë mendimin se rrallë (41.5%) ose ndonjëherë (41.1%) merren masa të tilla ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.


Tutje, të anketuarit janë pyetur edhe nëse vlerësojnë se gjykatat dhe prokuroritë kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët dhe prokurorët nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet apo frikësimet. Nga anketa rezulton se vetëm 6.5% e të anketuarve pajtohen plotësisht se këto institucione kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët/prokurorët nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet, apo frikësimet.

Ju lutem na tregoni se sa pajtoheni me deklaratën në vazhdim:

“Gjykatat/prokuroritë kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët/prokuroret nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet, apo frikësimet”




Sipas mendimint tuaj, a ka gjasa që të merren masa disiplinore deri në largim nga puna ndaj gjyqtarëve/prokurorëve të cilët i shkelin rregullat apo procedurat?



## SHËRBIMET NGA INSTITUCIONET E DREJTËSISË

Përmes këtij indeksi është synuar të dihet se brenda një periudhe kohore se sa qytetarët e vendit tonë kanë pranuar ose marrë shërbime nga Policia, Gjykata dhe Prokuroria. Në pyetjen se “A keni marrë/pranuar shërbime gjatë 5 viteve të fundit nga institucionet e drejtësisë?”, rezulton se 31% e të anketuarve (apo 3.1 pikë përqindje më shumë sesa në vitin e kaluar) kanë pohuar se kanë pranuar shërbime nga këto institucione gjatë periudhës së lartcekur.

A keni marrë/pranuar shërbime gjatë 5 viteve të fundit nga institucionet e drejtësisë (Policia, Prokuroria, Gjykata)?




## VETTINGU DHE KONFISKIMI I PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME NË PROCEDURË CIVILE

Gjatë vitit 2022, temat kryesore në kuadër të sundimit të ligjit kanë qenë iniciativat për Vettingun në sistemin e drejtësisë si dhe për krijimin e një institucioni të veçantë i cili do të merrej veçanërisht me verifikimin dhe konfiskimin civil të pasurisë së pajustificueshme, pa pasur nevojë që të ekzistojë aktgjykim dënues nga gjykata.

Kësisoj, në edicionin e tetë të RoLPIK-ut, për dallim nga edicionet e kaluara është përfshirë edhe indikator i perceptimit qytetar në raport me nismat për reforma në drejtësi; nëse këto nisma shihen si adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe rritjen e besimit në institucione të drejtësisë apo nëse ende qytetarët janë skeptik që nisma të tilla nuk do të kenë ndonjë rezultat konkret. Më konkretisht, në pyetjen e parashtruar se si i vlerësoni iniciativat e ndërmarra nga qeveria e Kosovës (Ministria e Drejtësisë) për të reformuar sistemin e drejtësisë, përfshirë vettingun dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, të anketuarit kanë pasur mundësinë që

të përgjigjen ndërmjet vlerave 1 dhe 5, ku vlera 1 nënkupton që këto nisma nuk janë aspak të mira ndërsa vlera 5 nënkupton që nismat e tilla janë plotësisht të mira. Ndërmjet këtyre koeficienteve të vlerësimit, mesatarja nga përgjigjet e dhëna del të jetë 3.6, që nënkupton se këto nisma shihen pozitive nga ana e qytetarëve, duke pritur kështu rritje të efikasitetit, pavarësisë, paanshmërisë dhe profesionalizmit në sistemin e drejtësisë përmes iniciativave të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Drejtësisë, gjatë vitit 2022.

Nga 1 në 5, si i vlerësoni iniciativat e ndërmarra nga qeveria e Kosovës (Ministria e Drejtësisë) për të reformuar sistemin e drejtësisë, përfshirë vettingun dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme?






## NIVELI I SIGURISË NË VEND

Risi në edicionin e tetë të RoLPIK-ut është gjithashtu indikator i perceptimit të qytetarëve në raport me nivelin e sigurisë në Kosovë. Kësisoj, nga qytetarët që kanë marrë pjesë në anketë është kërkuar të përgjigjen në pyetje se nga 1 në 5, ku vlera 1 nënkupton që qytetarët e vlerësojnë aspak të sigurtë nivelin e sigurisë në vend, kurse vlera 5 nënkupton se e vlerësojnë plotësisht të sigurtë gjendjen e sigurisë në Kosovë.

Nga 1 në 5, si e vlerësoni nivelin e sigurisë në vend




Qëllimi i parashtrimit të kësaj pyetje vie sidomos pas konfliktit rreth 1 vjeçar në Ukrainë dhe tendencave për destabilizim të situatës në Veri të Kosovës nga ana e shtetit të Serbisë. Gjatë vitit 2022, në disa raste u shënuan incidente si vendosja e barrikadave nga qytetarët serb që jetojnë në katër komunat veriore të Kosovës, sulmi ndaj zyrës së Komisionit Komunal zgjedhor në Mitrovicën e Veriut, sulmet ndaj gazetarëve, pengimi i punës së gjykatës, bojkotimi dhe dorëheqja e një pjese të madhe të zyrtarëve serb nga institucionet e Kosovës, përfshirë këtu ata që ishin në Qeveri, Kuvend, Polici, Gjykata e Prokurori.

Nga të dhënat e anketës rezultoi se qytetarët e Kosovës vlerësojnë se gjendja e sigurisë në vend është mbi mesatare, duke e vlerësuar gjendjen e sigurisë në vlerën 3.42. Pra, zhvillimit brenda vitit 2022 në aspektin e sigurisë së brendshme por edhe asaj ndërkombëtare kanë ndikuar edhe në perceptimin qytetarë në raport se si e shohin nivelin e sigurisë në vend.

## DËNIMET NË RASTET E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS NË BAZA GJINORE

Marrë parasysh që në vitin e kaluar pati shumë reagime dhe kritika ndaj sistemit të drejtësisë sa i përket trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, në këtë botim të RoLPIK–ut është përfshirë edhe indikator i që synon të vë në pah se a i konsiderojnë parandaluese dënimet e gjykatave që shqiptohen ndaj personave që shpallen fajtorë për këto vepra penale. Nga anketa e realizuar në shtator të 2022-tës, rezulton se ndërmjet vlerave 1=aspak meritore dhe 5=plotësisht meritore, dënimet që shqiptohen ndaj të akuzuarve për dhunë në familje apo/ dhe dhunë në baza gjinore janë meritore dhe parandaluese në vlerën 2.97. Pra, një mesatare e tillë lë të nënkuptohet se qytetarët ndajnë mendimin që duhet të kemi politikë ndëshkimore më efektive dhe dënime me të larta ndaj të gjithë atyre që ushtrojnë dhunë brenda marrëdhënies familjare apo në rastet kur viktimat janë sulmuar mbi baza gjinore, në mënyrë që rastet e tilla të parandalohen në të ardhmen.

Nga 1-5 sa meritore (parandaluese) konsideroni që janë dënimet për rastet e dhunës në familje/baza gjinore?



# **VLERËSIMI I PUNËS SË SISTEMIT TË DREJTËSISË**

## Vlerësimi i punës së sistemit të drejtësisë

Në edicionin e tetë të RoLPIK, vlerësimi i punës së sistemit të drejtësisë është bërë në bazë të analizimit të raporteve zyrtare të punës së gjykatave dhe prokurorive për vitin 2022, ku përfshihen të dhëna lidhur me numrin e lëndëve të zgjidhura, efikasitetin e punës, ngarkesën e prokurorëve dhe gjyqtarëve, shkallën e mbipopullimit dhe kohën për të cilën me punë të njëtrajtshme sistemi do të arrinte të përmbyllte lëndët aktuale. Të dhënat nga sistemi gjyqësor janë analizuar të ndara në bazë të punës së Gjykatës Supreme të Kosovës (GJS), Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), Gjykatës së Apelit të Kosovës (GJA), shtatë Gjykatave Themelore (GJTH) dhe Gjykatës Komerciale (GJK). Në anën tjetër, vlerësimi i punës së sistemit prokurorial është bërë për: Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), Prokurorinë e Apelit (PA), Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) dhe shtatë Prokuroritë Themelore (PTH).

Duke pasur parasysh rrethanat e krijuara pas përhapjes së pandemisë COVID-19 gjatë vitit 2020 dhe 2021, të cilat kanë ndikuar që gjykatat dhe prokuroritë e vendit për një kohë të trajtojnë vetëm rastet me urgjencë dhe të njëjtat kanë punuar me staf të reduktuar. Është e rëndësishme që të merret parasysh se tek këta indikatorë strukturorë vlerësohet vetëm aspekti sasior i punës së prokurorive dhe gjykatave për një vit kalendarik dhe jo vështirësia dhe mënyra e zgjidhjes së lëndëve.

Po ashtu, fokus i veçantë i është dhënë analizimit të shkallës së ndarjes së buxhetit për të vlerësuar prioritizimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë në raport me buxhetin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022.

# **PERFORMANCA E PROKURORIVE**



## Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve në raport me rastet e reja dhe ato të trashëguara

Në bazë të raportit të punës së prokurorive për vitin 2022<sup>17</sup>, Prokurori i Shtetit (ZKPSH, PA, PSRK dhe shtatë Prokuroritë Themelore), i përbërë nga 181 prokurorë, në punë kishte 132 mijë e 950 lëndë, prej tyre 81 mijë e 952 lëndë të trashëguara nga vitet paraprake dhe 50 mijë e 998 lëndë të reja të pranuar gjatë kësaj periudhe kohore. Ndërsa, nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2022, prokurorët kanë zgjidhur 44 mijë e 247 lëndë, apo 33% të numrit total të kallëzimeve penale që i kanë pasur në punë.

Nëse marrim për bazë shkallën e efikasitetit të treguar në vitin 2022, në mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe atyre që ishin në punë del se Prokurorit të Shtetit do t'i duhen rreth 3 vite për të përfunduar të gjitha lëndët që kanë statusin si lëndë aktive, me kusht që brenda kësaj periudhe kohore nuk pranon lëndë të reja.

Kurse, nëse marrim shkallën e efikasitetit në mes numrit të lëndëve të reja dhe atyre të zgjidhura, rezulton se Prokurori i Shtetit ka treguar efikasitet prej 87%. Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë se gjatë vitit 2022, ZKPSH dhe PA kanë arritur efikasitet prej 100% në zgjidhjen e numrit të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të reja që i kanë pranuar gjatë kësaj periudhe kohore. Ndërsa, shtatë Prokuroritë Themelore dhe PSRK në vitin e kaluar kanë zgjidhur me pak lëndë sesa që kanë pranuar, duke bërë kështu që këtyre institucioneve në vitin 2023 t'i barten lëndë që nuk morën epilog gjatë vitit paraprak.

**Tabela 1.** Përqindja e efikasitetit të Prokurorit të Shtetit në zgjidhjen e lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar gjatë viteve 2013-2022

Viti	Zyra e Kryeprokurorit	Prokuroria Speciale	Prokuroria e Apelit	Prokuroritë Themelore
2022	100	75	100	84
2021	100	70	102	99
2020	100	153	100	118
2019	100	59	116	153
2018	102	105	99	127
2017	98	93	100	112
2016	101	192	100	112
2015	102	125	100	94
2014	96	51	100	71
2013	101	94	100	80

17 Këshilli Prokurorial i Kosovës, Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2022, i qasshëm në linkun: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/RAPORTI%20VJETOR%20I%20PROKURORIT%20TE%20SHTETIT%202022.pdf>

## Raporti në mes numrit të lëndëve në punë dhe numrit të prokurorëve

Siç u theksua më lart, Prokurori i Shtetit gjatë viti 2022, kishte të angazhuar 181 prokurorë ku 9 prej tyre janë në ZKPSH, 7 në PA, 17 në PSRK dhe 148 prokurorë në kuadër të shtatë Prokurorive Themelore. Ndërsa, përmes përcaktimit të shkallës së ngarkesës së prokurorëve identifikohet numri mesatar i lëndëve që një prokuror pritët t'i zgjidh brenda një viti pune. Përlllogaritja e këtij indikatori bëhet përmes shumës së lëndëve të pazgjidhura në fillim të vitit dhe lëndëve të reja të pranuar, në raport me numrin e prokurorëve të angazhuar gjatë po këtij viti. Këto lëndë nuk janë trajtuar në aspektin cilësor të vështirësisë, por vetëm në aspektin sasior të numrit mesatar të lëndëve të cilat i pranon një prokuror brenda vitit.

**Tabela 2.** Mesatarja e lëndëve që kanë pasur në punë prokurorët gjatë viteve 2013 – 2022

Viti	Zyra e Kryeprokurorit	Prokuroria Speciale	Prokuroria e Apelit	Prokuroritë Themelore
2022	160	128	1115	821
2021	154	129	1012	810
2020	136	128	1471	753
2019	151	146	1160	920
2018	142	116	1148	1047
2017	203	46	724	404
2016	234	72	880	506
2015	412	53	645	540
2014	155	50	549	463
2013	217	48	584	509

## Buxheti për sistemin prokurorial gjatë vitit 2022

Përmes buxhetit mund të parashikohet për çdo vit sesa me prioritet trajtohen kërkesat e sistemit të drejtësisë për funksionimin e mirëfilltë e gjykatave dhe prokurorive si dhe në ofrimin e shërbimeve sa më profesionale ndaj qytetarëve.

**Tabela 3.** Buxheti i KPK-së gjatë viteve 2013 - 2022

	Buxheti i KPK-së	Buxheti i Republikës së Kosovës	Shpërndarja në %
2022	<b>17,144,178€</b>	2,735,749,600€	<b>0.63</b>
2021	<b>14,441,528€</b>	2,454,209,105€	<b>0.59</b>
2020	<b>15,021,836€</b>	2,356,860,915€	<b>0.64</b>
2019	<b>14,170,065€</b>	2,378,231,797€	<b>0.59</b>
2018	<b>11,092,826€</b>	2,080,480,837€	<b>0.53</b>
2017	<b>9,483,682€</b>	2,001,020,484€	<b>0.47</b>
2016	<b>8,013,619€</b>	1,678,709,487€	<b>0.48</b>
2015	<b>7,158,086€</b>	1,682,486,849€	<b>0.43</b>
2014	<b>6,872,000€</b>	1,589,324,952€	<b>0.43</b>
2013	<b>5,775,534€</b>	1,591,118,599€	<b>0.36</b>

Të dhënat për buxhetin e ndarë ndër vite për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) tregojnë një rritje të vazhdueshme nga viti 2013 deri në vitin 2022, në proporcion me rritjen e buxhetit të shtetit. Në vitin 2022, ishte ndarë shuma më e lartë buxhetore për KPK-në që prej vitit 2013, e cila kapi vlerën prej 17 milion e 144 mijë e 178 euro, por në përqindje, shpërndarja e buxhetit të Kosovës për sistemin prokurorial asnjëherë nuk ka arritur 1% të buxhetit të përgjithshëm të shtetit.<sup>18</sup>

Si në të kaluarën, rritja e të ardhurave, planifikimi dhe hartimi i linjave buxhetore të rritura për KPK-në nuk kanë ardhur si rezultat i ndonjë politike për prioritizimin e sistemit të drejtësisë, apo bazuar në ndonjë vlerësim të nevojave, por kanë ardhur si rezultat i rritjes së buxhetit vjetor të shtetit. Buxheti i paraparë për KPK-në gjatë vitit 2022 ishte shpërndarë 65.2% për paga dhe mëditje, 13.9% për mallra dhe shërbime, 1.2% për shpenzime komunale dhe rreth 20% për shpenzime kapitale. Kjo shpërndarje tregon se pjesa më e madhe e buxhetit të alokuar për sistemin prokurorial i dedikohet pagave dhe mëditjeve, duke lënë shume pak hapësirë për planifikim e ndarje të mjeteve financiare për ngritje kapacitetesh apo profilizim të prokurorëve dhe stafit mbështetës.

<sup>18</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, link: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F77FA35-E121-43D3-9683-791BOADE3337.pdf>

# **PERFORMANCA E GJYKATAVE**

## Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve në raport me rastet e reja dhe ato të trashëguara

Në bazë të raportit të punës së gjykatave për vitin 2022<sup>19</sup>, rezulton se gjyqësori (Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit, shtatë Gjykatat Themelore dhe Gjykata Komerciale), në punë kishte 381 mijë e 786 lëndë, prej tyre si lëndë të trashëguara ishin 229 mijë e 404 raste ndërsa të pranuar si lëndë të reja ishin 152 mijë e 382 çështje gjyqësore. Ndërsa, nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2022, gjyqtarët kanë zgjidhur 97 mijë e 456 lëndë, apo 31.3% të total rasteve që ishin aktive gjatë kësaj periudhe kohore.

Nëse marrim për bazë shkallën e efikasitetit të treguar në vitin 2022, në mes numrit të lëndëve të zgjidhura dhe atyre që ishin në punë, del se gjykatave do t'i duheshin mbi 3 vite për të përfunduar të gjitha lëndët që kanë statusin si lëndë aktive, me kusht që brenda kësaj periudhe kohore nuk pranojnë lëndë të reja. Kurse, nëse marrim shkallën e efikasitetit në mes numrit të lëndëve të reja dhe atyre të zgjidhura, rezulton se Prokurori i Shtetit ka treguar efikasitet prej 78%.

**Tabela 4.** Përqindja e efikasitetit të gjykatave në zgjidhjen e lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar gjatë viteve 2013-2022

Viti	Gjykata Supreme	Dhoma e Posaçme	Gjykata e Apelit	Gjykatat Themelore	Gjykata Komerciale
2022	114	165	91	76	50
2021	99	203	79	66	
2020	84	264	106	60	
2019	95	135	108	177	
2018	110	92	97	161	
2017	98	112	90	145	
2016	89	130	186	110	
2015	105	46	89	98	
2014	98	28	92	109	
2013	201	54	103	80	

Të dhënat e paraqitura në tabelë tregojnë se gjatë vitit 2022, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë arritur përqindjen më të lartë të efikasitetit në zgjidhjen e numrit të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të reja që i kanë pranuar gjatë asaj periudhe kohore. Më pas renditet Gjykata e Apelit me 91% efikasitet dhe shtatë gjykatat themelore së bashku me 76%. Ndërsa, lidhur me punën e Gjykatës Komerciale, e cila u funksionalizua nga muaji gusht i vitit 2022, të dhënat tregojnë se kjo gjykatë deri më 31 dhjetor treguar efikasitet vetëm 50%, përkatësisht nga 2 mijë e 73 lëndë të pranuar ka zgjidhur vetëm 1 mijë e 39 të tilla.

Meqenëse, Gjykata e Apelit, shtatë gjykatat themelore dhe Gjykata Komerciale nuk arritën që brenda vitit 2022 të zgjidhin raste aq sa pranuan, kjo nënkupton se këto institucione përsëri do të kenë sfidë rastet e trashëguara për shkak se edhe në vitin 2023 do t'u barten lëndë që nuk morën epilog gjatë viteve paraprake.

<sup>19</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti statistikor i gjykatave vjetor 2022, i qasshëm në linkun: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114\\_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/45114_RAPORTI%20STATISTIKOR%20I%20GJYKATAVE%20VJETOR%202022.pdf)

## Raporti në mes numrit të lëndëve në punë dhe numrit të gjyqtarëve

Përmes kësaj komponentë synohet të pasqyrohet se sa ka qenë ngarkesa e gjyqtarëve me lëndë gjatë periudhës raportuese Përlllogaritja e këtij indikatori bëhet përmes shumës së lëndëve të pazgjidhura në fillim të vitit dhe lëndëve të reja të pranuar, në raport me numrin e gjyqtarëve të angazhuar gjatë po këtij viti. Këto lëndë nuk janë trajtuar në aspektin cilësor të vështirësisë, por vetëm në aspektin sasior të numrit mesatar të lëndëve të cilat i pranon një gjyqtar brenda vitit. Kësisoj, nga të dhënat e raportit të punës së gjykatave për vitin 2022, rezulton se në sistemin gjyqësor ishin të angazhuar 404 gjyqtarë ku 385 prej tyre kanë qenë të ngarkuar me zgjidhjen e lëndëve (16 në Gjykatën Supreme, 14 në Dhomën e Posaçme, 53 në Gjykatën e Apelit, 292 në Gjykatat Themelore dhe 10 në Gjykatën Komerciale).

**Tabela 5.** Mesatarja e lëndëve që kanë pasur në punë gjyqtarët gjatë viteve 2013 – 2022

Viti	Gjykata Supreme	Dhoma e Posaçme	Gjykata e Apelit	Gjykatat Themelore	Gjykata Komerciale
2022	114	1246	642	1091	1005
2021	132	1267	649	896	
2020	99	1477	497	595	
2019	89	2070	552	899	
2018	86	1519	649	1330	
2017	106	1837	680	2224	
2016	88	1850	644	3187	
2015	83	1816	539	2848	
2014	75	2211	583	3080	
2013	121	821	558	3133	

Nga të dhënat e tabelës shihet se gjyqtarët e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme kanë pasur numrin me të madh të lëndëve në punë në raport me numrin e gjyqtarëve të angazhuar në këtë institucion. Pra, gjatë vitit 2022, një gjyqtar që shërben në këtë instancë gjyqësore ka qenë i ngarkuar me mesatarisht 1246 lëndë, i pasuar nga gjyqtari i Gjykatës Themelore me 1091 lëndë, ai i Gjykatës Komerciale me 1005 raste, i Apelit me 642 lëndë dhe në fund gjyqtari i Gjykatës Supreme me 114 raste gjyqësore.

## Buxheti për sistemin gjyqësor gjatë vitit 2022

Ligji nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, kishte paraparë një buxhet prej 32 milion e 184 mijë euro për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) që në raport me buxhetin e tërësishëm të vendit përbënte rreth 1.18%.<sup>20</sup> Nëse e shohim në raport me totalin e shumës së ndarë për sistemin gjyqësorë në vend vërejmë që gjatë viti të kaluar KGJK-ja ka pasur buxhetin më të lartë që nga viti 2013. por nëse e shohim përqindjen e shpërndarjes së buxhetit në raport me totalin e buxhetit të shtetit përgjatë viteve rezultoi se në 2022, KGJK-së ju kishte ndarë buxhet më pak vetëm në vitin 2017 dhe 2018. Përmes buxhetit mund të parashikohet për çdo vit sesa prioritet trajtohen kërkesat e sistemit të drejtësisë për funksionimin e mirëfilltë e gjykatave dhe prokurorive si dhe në ofrimin e shërbimeve sa më profesionale ndaj qytetarëve.

**Tabela 6.** Buxheti i KGJK-së gjatë viteve 2013 - 2022

	Buxheti i KGJK-së	Buxheti i Republikës së Kosovës	Shpërndarja në %
2022	<b>32,183,896€</b>	<b>2,735,749,600€</b>	<b>1.18</b>
2021	<b>29,194,592€</b>	<b>2,454,209,105€</b>	<b>1.19</b>
2020	<b>29,821,540€</b>	<b>2,356,860,915€</b>	<b>1.27</b>
2019	<b>29,404,466€</b>	<b>2,378,231,797€</b>	<b>1.24</b>
2018	<b>23,495,024€</b>	<b>2,080,480,837€</b>	<b>1.13</b>
2017	<b>21,793,948€</b>	<b>2,001,020,484€</b>	<b>1.09</b>
2016	<b>20,465,770€</b>	<b>1,678,709,487€</b>	<b>1.22</b>
2015	<b>21,288,771€</b>	<b>1,682,486,849€</b>	<b>1.27</b>
2014	<b>20,833,483€</b>	<b>1,589,324,952€</b>	<b>1.31</b>
2013	<b>19,910,467€</b>	<b>1,591,118,599€</b>	<b>1.25</b>

Të dhënat për buxhetin e ndarë ndër vite për KGJK-në tregojnë se në tri vitet e fundit kemi trend të uljes së përqindjes në mes buxhetit të tërësishëm të Republikës së Kosovës dhe mjeteve që destinohen për nevojat dhe kërkesat e sistemit gjyqësor në vend. Ndryshe, këto mjete ashtu si edhe në vitet paraprake, edhe në 2022-tën, pjesa më e madhe e tyre janë shpërndarë në paga dhe mëditje (78%), mallra dhe shërbime (12.4%), shpenzime kapitale (7%) dhe shpenzime komunale (1.2%). Kjo shpërndarje tregon se pjesa më e madhe e buxhetit të alokuar për sistemin gjyqësor i dedikohet pagave dhe mëditjeve, duke lënë shume pak hapësirë për planifikim e ndarje të mjeteve financiare për ngritje kapacitetesh, profilizim të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës si dhe për krijimin e kushteve me të mira të punës për stafin e gjykatave.

<sup>20</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, link: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1F77FA35-E121-43D3-9683-791BOADE3337.pdf>









# Rreth RoLPIK

RoLPIK ka për qëllim kryesor të promovoj përmirësimin epjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve në kërkimin e përgjegjësisë mbi performancën e sistemit të drejtësisë, përmes monitorimit, konsultimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm.

Për më shumë rreth platformës RoLPIK dhe Drejtësia Sot, vizitoni këtu:

[www.rolpik.org](http://www.rolpik.org)

[www.rolpik.org/justicetoday/](http://www.rolpik.org/justicetoday/)

 **HEINRICH BÖLL STIFTUNG**  
Die grüne politische Stiftung



Group for Legal  
and Political  
Studies

---

*Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë – Botimi i Tetë financohet nga Heinrich Böll Stiftung – HBS. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe nuk i reflekton qëndrimet e Heinrich Böll Stiftung – HBS.*



